

## **NJOFTIM PËR KRYERJE PUNIMESH**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, banues ne lagjen \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se do të kryej punimet e mëposhtme :

**Neni 6):** “Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e mëposhtme **kryhen pa pajisje me leje ndërtimi dhe pa paraqitur deklaratë paraprake punimesh:**

**a) Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë:**

(i) ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si më poshtë vijon:

- rifreskimi i lysterjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese \_\_\_\_\_

- pastrimi i fasadave \_\_\_\_\_

- riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente \_\_\_\_\_

- zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes \_\_\_\_\_

- riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve e oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme \_\_\_\_\_

- riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse \_\_\_\_\_

- vendosja e hekurave mbrojtës në dritare \_\_\_\_\_

- vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave \_\_\_\_\_

- sistemimi i oborreve \_\_\_\_\_

- riparimi i rrethimeve ekzistuese \_\_\_\_\_

**(ii) ndërhyrje të brendshme:**

- riparimi dhe rinovimi i dyshemeve \_\_\_\_\_

- riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave \_\_\_\_\_

- riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë \_\_\_\_\_

**(iii) ndërhyrje në impiante higjeno-sanitare:**

- veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjeno-sanitare dhe riparimet e impiantit \_\_\_\_\_

**b) Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara** \_\_\_\_\_

**c) Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore** \_\_\_\_\_

Deklaruesi

---